Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0470

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së OE ARHIKO.ING SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Hartimi i projekteve kapitale për nevojat e Kuvendit Komunal Novobërdë" me numër të prokurimit 654-23-1051-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Novobërdë, më 05/09/2023, mori këtë:

Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e ARHIKO.ING SH.P.K. me nr. 2023/0470, e datës 06/07/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Hartimi i projekteve kapitale për nevojat e Kuvendit komunal Novobërdë", me numër të prokurimit 654-23-1051-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Novobërdë, ndërsa vendimi i AK Vërtetohet.

2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 16.02.2023 AK – Kuvendi Komunal Novobërd,në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull "Hartimi i projekteve kapitale për nevojat e Kuvendit komunal Novobërdë" me numër të prokurimit 654-23-1051-2-2-1.

Ndërsa me datën 21.06.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me te cilin ka shpërblyer me kontratë GOE RIMI ENG sh.p.k, N.SH 3D – PROJECT, NTSH Studio Zero.

Me datën 26.06.2023 Operatori ekonomik ankues "ARHIKO.ING" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Ndërsa AK me datën 29.06.2023 ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën per rishqyrtim të operatorit ekonomik.

I pakënaqur me vendimin e AK, me datën 06.07.2023 Operatori ekonomik ARHIKO.ING SH.P.K, ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0470.

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, Lloji i kontratës: shërbime, Vlera e parashikuar e kontratës: 20,000.00 €.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu edhe nenit 108/A të ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie në kompetencat e tij në kuptim të nenit 105 të LPP.

-*Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 26.07.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar,

- Të mbetet në fuqi Vendimin i AK.

Raporti i ekspertizës i cituar si më sipër përmban elementet qenësore dhe i njëjti i është dërguar autoritetit kontraktues dhe ankuesit. Lidhur me këtë raport të ekspertizës AK është pajtuar me mendimin e ekspertit ndërsa Operatori ekonomik ankues nuk është pajtuar me mendimin e ekspertit.

Përgjigje në Pretendimet Ankimore të OE ankues ARHIKO.ING SH.P.K

OE ankues pretendon se: "Me datën 26.04.2023 është bërë publikimi i parë i Njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe letrat standarde ku kompania jonë është shpallur si kompani fituese, ndërsa kompanitë e tjera të papërgjegjshme për dokumente e prezantuara, ku koncerisumi Rimi ENG Shpk &3D-Projekt& Studio Zero janë eliminuar pasi që nuk ka prezantuar deklaratën nën betim për njërin nga anëtaret e saj. Kompania në fjalë ka dërguar kërkesë për rishqyrtim dhe autoriteti ka aprovuar kërkesën e tyre dhe me datën 17.05.2023 ka propozuar për shpërblim me kontratë, kompania jonë si një palë e interesuar në këtë procedurë ka kërkuar qasje në dokumente zyrtare me datën 18.05.2023, pas qasjes kompania jonë ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datën 18.05.2023. ku me datën 25.05.2023 kërkesa për rishqyrtim na është

aprovuar, Mirëpo përkundër se aprovuar me datën 21.06.2023 autoriteti kontraktues ka shpallur fitues po te njëjtën kompani, ku pas qasjes ne kemi hasur në shkeljet në vijim: Pas qasjes shihet qartas shkeljet si ne vijim:

-Ne kërkesën për vetëtime te datës 12.05.2023 është kërkuar qe te paraqitet:


tenderit.-

3. Vërtetimi mbi kryerjen e taksave ndaj tatimit ne prone emër te pronarit

Nëse brenda pesë ditëve nuk jeni ne gjendje ti ofroni këto dëshmi qe janë kërkuar oferta e juaj do konsiderohet si ofertë e pa përgjegjshme .
Ju falënderohem për mirëkuptim.

Pas qasjes shihet qe OE:

-3D-Projekt - Vërtetimin e paraqitur adresa e cila është e paraqitur ne këtë vërtetim nuk ka përputhje me adresën e regjistrimit te biznesit ne ARBK.

- Rimi ENG- Vërtetimin e paraqitur adresa e cila është e paraqitur ne këtë vërtetim nuk ka përputhje me adresën e regjistrimit te biznesit ne ARBK, si dhe ne këtë dokument është paraqitur qe Safet Lipovica si pronar ndërsa ne ARBK është Nadire Lipovica e cila ka dallim në të dhënat.

-Studio Zero - Vërtetimin e paraqitur adresa e cila është e paraqitur në këtë vërtetim nuk ka përputhje me adresën e regjistrimit te biznesit ne ARBK si dhe në këtë dokument nuk është i paraqitur numri unik identifikues i biznesit mirëpo me numrin personal të pronarit. Nga këto shkelje si në vijim shihet qartas qe GOE nuk ka përmbushur kërkesën e Autoritetit Kontraktues te datës 12.05.2023. Si te tille GOE është dashur te shpallet i papërgjegjshëm."

Eksperti shqyrtues sqaron se AK me datën 12.05.2023 ka bërë kërkesë për vërtetime ku ka kërkuar nga OE i rekomanduar të dërgojnë edhe disa vërtetime shtesë si më poshtë:

Te nderuar,

Përmes kësaj shkrese dëshiroj te ju njoftoj se komisioni vlerësues ka propozuar qe kontrata për projektin **Hartimi i projekteve kapitale për nevojat e Kuvendit komunal Novobërdë** ti epet, Koncerziumit tuaj duke kërkuar nga ana e juaj qe ne afat prej 5 ditëve pas pranimit te këtij njoftimi te dorëzoni në zyrën e prokurimit dokumentet e përshtatshmëri (PËR TE TRE OE PJESMARËS NË KËTË KONZERCIUM) siç janë kërkuar gjatë njoftimit për kontratë për këtë aktivitet te prokurimit për te dy kompanit :

Dokumentet qe duhet ti dorëzoni janë:

1. Vërtetim nga gjykata ekonomike (jo me te vjetër se tre muaj) se OE nuk është i dënuar sipas nenit 65 të LPP -
2. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit.-
3. Vërtetimi mbi kryerjen e taksave ndaj tatimit ne prone emër te pronarit

Nëse brenda pesë ditëve nuk jeni ne gjendje ti ofroni këto dëshmi qe janë kërkuar oferta e juaj do konsiderohet si ofertë e pa përgjegjshme .

Ju falënderohem për mirëkuptim.

AK në pikën 3 të kësaj kërkese ka kërkuar që vërtetimi mbi kryerjen e taksave ndaj tatimit në pronë të jetë në emër të pronarit. Siç mund të shihet nga dosja e GOE, dy nga OE kanë ofruar vërtetimin e kërkuar në emër të pronarit mirëpo njëri OE përkatësisht vërtetimi i dërguar në AK nga RIMI ENG SH.P.K nuk është në emër të pronares e cila figuron në Certifikatën për Biznes, znj. Nadire Lipovica por është në emër të z. Safet Lipovica i cili nuk figuron që është pronar i këtij OE.

Eksperti shqyrtues ka kërkuar sqarime shtesë nga Rimi ENG SH.P.K në lidhje me vërtetimin ndaj tatimit në pronë i cili nuk është dorëzuar në emër të znj. Nadire Lipovica e cila figuron si pronare e OE, por në emër të z. Safet Lipovica. Sipas kërkesës kemi marrë këtë përgjigje:

NL

Nderim Lipovica <rimi-eng@hotmail.com> 2 1:21 PM

Sqarimi i Kërkesës

Retention Policy DelFiveYOldEm (5 years) Expires 7/22/2028

You replied to this message on 7/24/2023 1:26 PM.

Pershendetje
Ju informoj se selia e Rimi ENG SHPK eshte ne banese e bashkeshortit tim z.Safet Lipovica i cili nuk eshte pronar i Rimi ENG SHPK por eshte pronar i baneses.
Andaj une Nadire Lipovica si pronare e RIMI ENG SHPK nuk kam asnje prone ne emrin tim personal qe te kem ndonje vertetim te tatimit ne pronë.Kjo mund te vertetohe ne sistemin online apo ju si instuticione mund te verifikon shjme lehet te dhenat.
Une deklarohem nen betim se te dhenat e larteshenuara dhe ato te prezentuara pran AK Kuvedi Komuna e Novoberdes per tenderin HARTIMI I PROJETEVE KAPITALE ME NR PROKURIMIT 654-23-1051-221,per te cilin jane prezentuar jane te verteta dhe vetem te verteta.

Ne pritje te pergjigjes suaj.
Me respekt
Nadire Lipovica
044 481 247

Sent from Outlook

Sipas sqarimit të bërë nga Rimi ENG SH.P.K, mendimi i ekspertit shqyrtues është se pasi që znj. Nadire Lipovica nuk ka asnjë pronë me emrin e saj, e ka të pamundur që të ofroj dëshmi se ka paguar borxhin për tatimin në pronë, andaj duke marrë parasysh këtë fakt ajo e ka ofruar vërtetimin në emrin e bashkëshortit të saj z. Safet Lipovica, i cili është pronar i banesës, e cila është seli e Rimi ENG SH.P.K.

Sa i përket pretendimit se GOE në vërtetimet e dërguar kanë mospërputhje mes adresave në vërtetim dhe certifikatës së biznesit, eksperti shqyrtues mendon që ky pretendim është i pabazuar për faktin se komuna përkatëse ku këta OE kanë aplikuar për marrjen e këtij vërtetimi, ju ka lëshuar vërtetimet e kkërkuara edhe me emër të OE.

Pretendimi 2

"Pas qasjes në dokumente zyrtare ne e shohim qe Inxhinieret ne këtë procedure te prokurimit nuk kane kontrata sipas Ligji Nr. 03/L-212-LIGJ TË PUNËS-Neni 10 Kontrata e Punës mirëpo inxhinieret ne fjale kane vetëm draft kontrata ku shihet qartas qe kontratat e tyre nuk përmbushin

kërkesën dhe nuk janë sipas ligjit te punës. Gjate shqimit te kontratave shihet qe kontratat me inxhinieret si Veton Mustafa, ku ne kontrate shkruhet qe Ing, ka detyre te udhëheqjes, mbikëqyrjes dhe monitorimit te punëve te ndërtimtarisë për projektin, Kontrata e Ingjinerit nuk ka te beje me Hartim projekteve, por me udhëheqje, mbikëqyrje dhe monitorimit te punëve te ndërtimtarisë për projekt. Andaj shihet qe Kontrata nuk përmbush kërkesën qe te ketë te angazhuar një Inxhinier Projektet për Hartimin e projekteve, por për shërbime tjera.

Gjate shqimit te kontratave shihet qe kontratat me inxhinieret si Mentor Ibishi, ku ne kontrate shkruhet qe Ing, ka detyre te udhëheqjes, mbikëqyrjes dhe monitorimit te punëve te ndërtimtarisë për projektin:///Kontrata e Ingjinerit nuk ka te beje me Hartim projekteve, por me udhëheqje, mbikëqyrje dhe monitorimit te punëve te ndërtimtarisë për projekt. Andaj shihet qe Kontrata nuk përmbush kërkesën qe te ketë te angazhuar një Inxhinier Projektet për Hartimin e projekteve, por për shërbime tjera.

Gjate shqimit te kontratave shihet qe kontratat me inxhinieret se është paraqitur kontrate për Inxhinierin Selami Bugaqku, ndërsa është lëshuar edhe një vendim nga OE-3D-Projekt se inxhinieri ne fjale nuk mund te lidh kontrate pasi qe është pronar i OE-3D-Projekt, këtu shihet mos përputhje në mes dokumenteve te prezantuar në mes vete si të tillë autoriteti kontraktues është dashur ti shpall te papërgjegjshëm pasi qe shihet qartas qe ky GOE nuk ka dorëzuar ofertën ne baze kërkesave."

Eksperti shqyrtues sqaron se në dosjen e tenderit tek kërkesat teknike dhe profesionale është kërkuar që OE me stafin teknik të kenë marrëveshje për angazhim në rast se OE do të jetë fitues.

Dëshmi:

3..Stafi teknik te këruar diplomat univerzirare kopje sivit si dhe Marveshjet për angazhimin e ketyre inxhinjerve ne rast se kompanijka do jet fituse e tenderit

Sa i përket emërtimit "Draft Kontratë" të përdorur nga GOE i rekomanduar në marrëveshjet për angazhim, nuk është relevante se çfarë emërtimi ka përdorur OE kur në rastin konkret ka të bëjë pikërisht me marrëveshjet për angazhimi të kërkuara nga AK. Po ashtu pretendimi sa i përket detyrave dhe përgjegjësive të cilat janë cekur në këto parakontrata të ngritur nga OE ankues nuk janë të bazuara, për faktin se në asnjë pikë në dosje të tenderit nuk janë kërkuar detyra apo përgjegjësi të caktuara të cilat duhet të përfshihen në kontratë. Pra qëllimi i punëve të cilat do të kryhen nga fituesi i tenderit janë shumë të qarta.

Eksperti shqyrtues në pretendimin tjetër të ngritur nga OE ankues në lidhje me Inxhinierin Selami Bugaqku, mendon se përderisa z. Bugaqku është edhe pronar i OE 3D-Project ai nuk ka nevojë të ketë kontratë angazhimi por që nuk e ka të ndaluar të angazhohet si inxhinier i ndërtimtarisë nga konzorciumi. Mirëpo përderisa në dosje të tenderit nga AK është kërkuar që i gjithë stafi teknik duhet të kenë marrëveshje angazhimi, edhe OE i rekomanduar është detyruar ta përmbushë këtë kërkesë, por ka cekur se pronari nuk mund të ketë kontratë në rastin se GOE shpallet fitues.



3D Project

LETËR SQARIM

Kompania Projektuse: **N.SH. "3D-PROJECT"** me nr:biznesi: **70119238** dhe adresë në Prishtinë
në Rrugen Muharrem Fejza, Mati:1, Blloku C13A, Nr:17
me anë të kësaj shkrese deklarojmë se **ing.dpl.ndertimtarise Selami Bugaqku** është
pronar i kompanis dhe `si i tillë nuk mund të ketë kontratë pune.

Prishtinë.
06.03.2023

N.SH. "3D-Project"

Pretendimi 3

Sipas OE ankues: "Ne këtë dosje te tenderit dhe pas shqyrtimit te dokumenteve dhe verifikimit ne ARBK shihet qartas qe OE-RIMI ENG SHPK pronare është Nadire Lipovica, ndërsa ne deklaratat e obligimeve dhe përgjegjësive si përfaqësues i OE është paraqitur Safet Lipovica, ndërsa deklarata nen betim dhe deklaratat tjera janë te nënshkruara nga Nadire Lipovica, në këtë procedurë nuk është ndonjë dokument ligjor, apo noterizim ku paraqitet z. Safet lipovica si përfaqësues ligjor i kompanisë për nënshkrim dokumente.

Këtu shihet qartas qe ka mospërputhje te përfaqësuesve ne deklarata, pasi qe në disa deklarata është paraqitur Safet Lipovica, ne disa dokumente Nadire Lipovica,"

Eksperti shqyrtues në pretendimin e tretë të ngritur nga OE ankues duke u bazuar në dokumentet e kërkuara shtesë nga AK gjatë rivlerësimit të ofertave, sqaron se ekziston një dokument ligjor, një autorizim i noterizuar, përmes të cilit znj. Nadire Lipovica e autorizon z. Safet Lipovica që të nënshkruaj për biznesin RIMI ENG SH.P.K. Sipas Ligjit Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 72- Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë,

pika 1 thotë se: Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomik është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomik që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Më poshtë shihen dëshmitë e dërguara nga RIMI ENG SH.P.K sipas kërkesës për sqarim nga AK si dhe dëshmi të tjera të dërguara nga Noterja znj. Arbena Shehu e cila edhe një herë tjetër konfirmon se autorizimi është i regjistruar dhe është lëshuar nga zyrja e saj e noterisë.

Republika e Kosovës
NOTER
Ma.Sc.ARBENA SHEHU
PRISHTINË

LRP Nr. 517/2020

A U T O R I Z I M B I Z N E S I

Sot me datë **24.01.2020 (njëzet e katër janar dy mijë e njëzet)**, para meje, e poshtë nënshkruara Arbena Shehu, noter në Prishtinë, Rr. "Garibaldi", Hyrja II/1, Nr. 5 me kërkesë dhe në bazë të deklaratës së vullnetit të lirë, të përpiluje shënimin (aktin) noterial **mbi Autorizim të Biznesit**, u paraqitën personalisht bashkëpronarët e kompanisë:

1. Kompania "RIMI ENG" SH.P.K., e regjistruar pranë Agjensisë për Regjistrimin e Biznesve, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Republika e Kosovës, me datë 01.11.2017, me **NUI 810068743**, me selí në Rr. "Abdullah Presheva", Hy.1, Nr.38 – Prishtinë, të cilën e përfaqëson pronarja **znj.Nadire Lipovica**, e bija e Ibrahim-it, e lindur në Tagjev – Kamenicë, më datë 03.01.1974 (tre janar një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër), me profesion frizere, e martuar, me vendbanim në Rr. "Abdullah Presheva", Z3-51, Prishtinë, shtetase e Republikës së Kosovës, identiteti i të cilës konstatohet në bazë të leximgjëfimit me nr. personal 1012432301 të lëshuar nga MPB-RKS, madhore me zotësi të plotë për të veprua;

Me këtë **AUTORIZIM** unë: **znj.Nadire Lipovica** pronare e Kompanisë **"RIMI ENG" SH.P.K.**, me të dhënat e larpërcekura, **AUTORIZOJ**:

z. z.Safet Lipovica, i biri i Mustaf-ës, i lindur në fshatin Koretin, Kamenicë, me datë 15.01.1973 (Pesëmbëdhjetë janar njëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre) i martuar, me profesion Inxhinier i ndërtimtarisë, me vendbanim në Rr. Abdullah Presheva", Hy-1, H-1, nr.38, kompleksi Mozaika, Prishtinë, shtetas i Republikës së Kosovës, identiteti i të cilit konstatohet në bazë të leximgjëfimit me nr. Personal 1012000070, të lëshuar nga RKS-MPB, madhor me zotësi të plotë juridike për të veprua.

1. Të kryej te gjitha punët e dalura procedurale dhe administrative lidhur me zhvillimin e biznesit te Kompanisë **Kompania "RIMI ENG" SH.P.K.**, pranë të gjitha organeve në nevojë si atyre Komunale dhe atyre Qendrore të Republikës së Kosovës.
2. Në emër të Kompanisë t'i kryej të gjitha procedurat në lidhje me doganimin dhe zhdoganimin e mallit në të gjitha pikat doganore në Kosovë.
3. Të lidhë dhe nënshkruaj Kontrata, me autoritetet kontraktuese (që lidhen me veprimtarinë e biznesit), si dhe të dorëzoj, nënshkruaj dhe pranoj çfardolo dokumenti pranë cilëdo institucion zyrtarë duke përfshirë ARBK, ATK etj., që kërkohet lidhur me procedimin e veprimeve të lartëpërmendura në emër te etnitetit biznesor në fjalë.
4. Të përfaqësoj Kompaninë pranë organeve kompetente në të gjitha procedurat kontestimore dhe jokontestimore.
5. Të ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale pranë organeve të Komunës së Prishtinës, të gjitha Drejtorëve të Komunës, si dhe Komunave tjera në territorin e Kosovës, për të gjitha çështjet, ku pala pranë komunave ose organeve komunale mund të jetë etniteti biznesor në fjalë.
6. T'i autorizoj punonjësit e Kompanisë, për shfrytëzimin e automjeteve brenda dhe jashtë territorit të Kosovës.
7. Në emër të Kompanisë, të nënshkruajë çfardo lloj **Kontrate Kredie** apo bashkëpunimi me të gjitha bankat që veprojnë brenda vendit, për çfardo lloj Produkti (kredi, OVD/linje kreditore, garancion, letërkredi, letërgarancion etj), të kryej transfere bankare pa ndonjë limit te caktuar, tërheqjen dhe depozitimin e të hollave, të këtë qasje në llogarinë bankare në emër të kompanisë, si dhe në rast nevoje hapje dhe mbyllje të llogarive. Të pranojë dhe kryej pagesa ne emër te llogarisë bankare të Kompanisë pa ndonjë limit të caktuar.

Faqe 1/2

8. Që të vozis automjetet në emër të Kompanisë, brenda dhe jashtë kufijve të territorit të Republikës së Kosovës.
9. Të ndërmarr të gjitha veprimet procedurale pranë Qendres se Regjistrimit të Automjeteve në cilëndo Komunë, lidhur me regjistrimin dhe ç'regjistrimin e automjeteve dhe vazhdimin e regjistrimit dhe veprime tjera lidhur me regjistrimin e automjeteve nën pronësine e etnitetit biznesor në fjalë.
10. Të më përfaqësoj në zyret Noteriale për nënshkrimin e Kontratave për Shitjen - Blerjen e automjeteve, këmbimin e automjeteve, zgjidhjen e kontratave te shitjes se automjeteve ne rast se vie deri tek ndonjë rast i këtille, nënshkrimin e Aneks Kontratave të shitblerjes së automjeteve, këmbimit, me furnitorë-palë të treta etj. në emër të etnitetit biznesor.
11. Që në emër dhe për interes timin të aplikoj si dhe të tërheq certifikatën që nuk jam nën hetime pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe pranë Policisë së Kosovës.
12. Gjithashtu autorizimmarrësi autorizohet që të dorëzoj, nënshkruaj dhe pranoj çfarëdo dokumenti pranë cilëdo institucion zyrtarë që kërkohet lidhur me procedimin e veprimeve të lartëpërmendura në emër të kompanisë.

Të gjitha veprimet te cilat do t'i ndërmerr i AUTORIZUARI në kontekst të këtij AUTORIZIMI i pranoj dhe i konsideroj sikurse t'i kisha ndërmarrë vet.

Ky AUTORIZIM vlen në kohë të pacaktuar derisa e njëjta nuk revokohet nga dhënësi i autorizimit. Siç u cek me sipër, AUTORIZIMI u përpilua dhe redaktua, konform vullnetit të AUTORIZIMDHENËSIT, i cili pasi e lexoi, ishte dakord me përmbajtjen e AUTORIZIMIT.

Unë i udhëzova palët se ndaj personave të tretë të ndërgjegjshëm ky autiorizim prodhon efekte juridike deri në momentin kur i autorizuari e posedon ekstraktin e autorizimit. Të njëjtin e nënshkroi pa vërejtje para meje, unë si Noter vërtetoj tërësisht aktin dhe nënshkruaj në bazë të ligjit.

Shpenzimet janë paguar nga pala në vlerë prej 20 € + 18 % TVSH, bazuar në Nenin 21 paragrafi 7 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2012 për Tarifat e Përkohshme Noteriale bazë për pagesën e shërbimit të noterëve.

Akti është përpiluar pa ndërprerje dhe në praninë të palëve në zyrën e noterit, sot me datë **24.01.2020 (njëzet e katër janar dy mijë e njëzet).**

DHËNËSI I AUTORIZIMIT:

KOMPANIA: "RIMI ENG" SH.P.K., të cilën e përfaqëson pronarja znj.Nadire Lipovica:

NOTER

Ma.Sc.Arbena Shehu

Po ashtu AK ka kërkuar edhe nga noteria Arbena Shehu që edhe njëherë t'a vërtetoj këtë autorizim. Dëshmitë e pranuara nga AK mund të shihen më poshtë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

DATË/A:	27.06.2023
PËR/ZA/TO:	Noteren Ma.Sc.Arbena Shehu
CC:	
NGA/OD/FROM:	Zyra e Prokurimit : FATOS AHMET MENAXHER I PROKURIMIT
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për vërtetësisë të Autorizimin e biznesit me nr LRP Nr 517/2020

Autoriteti Kontraktues KK Novobërdë është duke e zvillur aktivitetin e prokurimit për Hartimi i Projekteve Kapitale për nevojat e Kuvendit Komunal Novobërdë me Nr. të Prok: Nr. i prokurimit 654-23-1051-2-2-1 Nr i brendshëm NB 654 2023 008 221 ku pjesë e këtij AP është edhe Kompania Rimi ENG SHPK me seli në Prishtinë e cila në dokumentet e tenderit ka dorëzuar një Autorizim Biznesi me nr LRP nr 517/2020 të vertetuar (lidhur) në zyren e juaj më datë 24.01.2020 ndërmjet znj Nadire Lipovica dhe z.Safet Lipovica .

AK pas vlersimit të ofertave AK e ka shperblyer me kontratë Kompanin e lartë permendur por njëra nga Kompanit tjera pjesmarse në këtë AP ka kërkuar qasje në dokumentacionin e Kompanisë Rimi ENG SHPK dhe pastaj po pretendon se pikërisht ky Autrizim është i falsifikuar dhe duhet vertetuar dhe po kërkon shqyrtimin e vendimit te AK për dhënje te kësaj Kontate andaj për te marur një vendim sa më të drejt po kërkojë nga ana e juaj që të na informoni lidhur me vërtetësin e këtij autorizimi te lidhur praj zyres suaj më datë 24.01.2020.

Kësaj shkrese do ja bashkangjesim edhe nje kopje te Autorizimit .

Me rrespektë.

Fatos Ahmeti

From: Arbena Shehu <arbena.shehu@gmail.com>
Sent: 2023-06-27 11:28 PD
To: Fatos Ahmeti

Pershendetje i nderuar z.Fatos,
Shpresoj jeni mire dhe punet po ju ecin mirë,
Lidhur me kerkesen tuaj Autorizimi Lrp 517/2020 figuron i regjistruar ne librat e regjistrit dmth esht kryer ne zyren tone.
Me respekt



Duke u bazuar në dëshmitë dhe sqarimet e përmendura më lartë, rezulton se pretendimet e ngritura nga OE ankues janë të pabazuara.

-Mendimi i ekspertit shqyrtues-

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

- Konstatimet e Panelit Shqyrtues -

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në ketë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në ketë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhenë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar se në raportin e ekpertizës së tij.

Prandaj bazuar në faktet dhe rrethanat e shpjeguara shkurtimisht si më sipër në shkresat e kësaj lënde nuk gjendet ndonjë provë se AK ka aplikuar ndonjë kriter apo veprim që diskriminon, redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik.

- Përfundim -

Nisur nga shpjegimet si më sipër Paneli konsideron se AK ka vepruar në harmoni me dispozitat e cituara si më sipër të LPP dhe ka zbatuar drejtë dosjen e tenderit sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 27, sipas të cilit, autoriteti kontraktues përpilon dosjen e tenderit me të gjitha informatat përkatëse përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkese të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Në kuptim të kësaj dispozite, dosja e

tenderit përbën dokumentin kryesor të prokurimit dhe se publikimi i sajë supozohet të jetë në harmoni të plotë me qëllimet e LPP, të siguroj mënyrën efikase të shfrytëzimit të fondeve publike, të promovoj integritetin e vet procesit të prokurimit dhe të kulturës institucionale dhe të profesionalizuar.

Ndonëse mendimi i ekspertit nuk është detyrues, Paneli sipas mendimit të pavarur të tij e ka mbështetur raportin e ekspertit në rastin konkret, nisur nga parimi se vlera provuese e tij jepet gjithnjë me raport me vlerësimin, krahasimin dhe administrimin e të gjitha provave tjera dhe natyrën e një çështje në rastin konkret.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrur në ketë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 6, si dhe 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Paneli Shqyrtues niset gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre eksplicit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL NOVO BRDO**
- OE - **ARHIKO .ING SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: